



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë
Mbledhja nr. 96
Prishtinë, më 11.11.2024, në orën 9:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

P r o c e s v e r b a l

Në mbledhje morën pjesë: Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, Xhavit Haliti, Adelina Grainca, Yllza Hoti, Gazmend Gjyshinca, Ariana Musliu-Shoshi dhe Time Kadrijaj.

Munguan: Fitore Pacolli-Dalipi, Doarsa Kica-Xhelili dhe Bahrim Shabani.

E pranishme në takim: znj. Karin Boven, Ambasadore e Mbretërisë së Holandës në Kosovë dhe znj. Burbuqe Brahim, zyrtare e lartë për Politikë dhe Kulturë, Ambasada e Mbretërisë së Holandës.

Pjesëmarrës të tjerë: Lulzim Kelmendi UP-KPJD, Besarta Pllana, Leudita Mejzini dhe Adriana Osmani, Kuvendi i Kosovës.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Takimin e kryesoi Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 16 dhe 24 shtator, si dhe më 9 tetor 2024;
3. Takim me znj. Karin Boven, Ambasadore e Mbretërisë së Holandës në Kosovë;
4. Të ndryshme.

3. Takim me znj. Karin Boven, Ambasadore e Mbretërisë së Holandës në Kosovë;

Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, e falënderoi ambasadoren për praninë e saj në komision dhe e uroi atë për detyrën e re. Mbretëria e Holandës e ka mbështetur në vazhdimësi Republikën e Kosovës dhe se Kosova për këtë është falënderuese. Po ashtu, e falënderoi ambasadoren për përkrahjen e Holandës në procesin e anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Evropës, duke theksuar se ky është një proces që ende nuk ka marrë fund, por që me ndihmën e shteteve mike si Holanda, të cilat e mbështesin Kosovën për tu bërë anëtare, një gjë të tillë do të bëhet e mundur. Bëri të ditur se Kosova po ashtu, ka synime që të bëhet anëtare e Bashkimit Evropian dhe NATO-së, dhe njoftoi se Kosova ka dorëzuar aplikacionin e saj për t'u bërë shtet anëtar i BE-së. Kosova është duke punuar fuqishëm që t'i përafrohet anëtarësimit në NATO dhe pret nga shtetet si Holanda të ketë mbështetje në rrugëtimin e saj drejtë anëtarësimit në BE dhe në NATO.

Karin Boven, falënderoi kryetaren dhe anëtarët e komisionit për mikpritjen dhe shprehu kënaqësinë që është pjesë e këtij takimi. Ajo theksoi rëndësinë e raporteve të mira mes dy vendeve, të cilat kanë një histori bashkëpunimi të gjatë dhe të qëndrueshëm. Ambasadorja përmendi rolin e ish-ambasadorit në forcimin e këtyre marrëdhënieve dhe theksoi se synon të vazhdojë dhe të intensivikojë këto raporte të shkëlqyera. Ajo po ashtu shprehu mbështetjen e Holandës për aspiratat e Kosovës në anëtarësim në organizata ndërkombëtare si Këshilli i Evropës, Bashkimi Evropian dhe NATO. Duke përmendur progresin e Kosovës dhe përpjekjet për arritjen e standardeve ndërkombëtare, ajo tha se Kosova ka bërë hapa të rëndësishëm, por gjithsesi është ende një rrugë të gjatë përpara. Në vazhdim, ambasadorja diskutoi për rëndësinë e stabilitetit dhe paqes në botën e sotme, duke theksuar që sfidat globale dhe rajonale janë të shumta. Ajo përmend përvojën e saj në vende me situata të vështira, si Uganda, Sudani dhe Afganistani, dhe theksoi nevojën për bashkëpunim në promovimin e paqes dhe stabilitetit global.

Xhavit Haliti, i shprehu mirëseardhje ambasadores, duke e vlerësuar këtë takim si një mundësi të veçantë për të thelluar marrëdhëniet mes Kosovës dhe Holandës. Ai theksoi se Holanda është një vend çmuar për Kosovën, sidomos brenda strukturave të BE-së dhe NATO-s. Ai shprehu besimin se Holanda mund të luajë një rol të rëndësishëm në forcimin e raporteve mes dy vendeve dhe, veçanërisht, në ndërtimin e një komunikimi të drejtpërdrejtë dhe produktiv mes parlamenteve të Kosovës dhe Holandës. Z. Haliti sugjeroi që të krijohen takime zyrtare mes parlamenteve, duke përforcuar dialogun dhe bashkëpunimin institucional. Ish-kryeministri i Holandës tha se tashmë ka një rol të rëndësishëm në NATO dhe se Kosova përmes ambasadores mund ndikojë në rritjen e bashkëpunimit, veçanërisht për të adresuar çështje që lidhen me Kosovën dhe Ballkanin Perëndimor. Duke përmendur ndryshimet e mundshme pas zgjedhjeve në SHBA, z. Haliti theksoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar për Kosovën në këtë periudhë kritike, sidomos në procesin e anëtarësimit në BE. Më tej theksoi se për Kosovën është e rëndësishme që t'i përmbushë detyrimet e saj të brendshme dhe t'i kapërcejë vështirësitë duke u mbështetur në ndihmën dhe mbështetjen e aleatëve ndërkombëtarë, duke përfshirë Holandën, e cila është aktive në Këshillin e Evropës dhe në organizata të tjera ndërkombëtare. Bëri të ditur se në Këshillin e Evropës, përfaqësuesit holandezë kanë qenë të angazhuar dhe aktivë, sidomos në trajtimin e çështjeve të zgjerimit të BE-së dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Karin Boven, sa i përket NATO-s, tha se Holanda, me emërimin e ish- kryeministrit z. Mark Rutte si Sekretar i Përgjithshëm, tashmë ka një aset brenda kësaj aleance. Theksoi se z. Rutte vitin e kaluar e ka vizituar Kosovën dhe se e njuh shumë mirë Kosovën. Holanda, tha se është e gatshme të kontribuojë më shumë në KFOR dhe se kjo mund të ndihmojë edhe në përshpejtimin e proceseve që i synon Kosova.

Yllza Hoti, i uroi mirëseardhje ambasadores dhe shprehu mirënjohje për mbështetjen e vazhdueshme që Holanda i ka ofruar Kosovës. Ajo vlerësoi veçanërisht Projektin “Matra”, i cili ka promovuar të drejtat e njeriut në Kosovë për më shumë se 20 vite që nga përfundimi i luftës. Znj. Hoti e konsideron këtë projekt si një element të rëndësishëm për Kosovën, duke pasur ndikim të madh tek të rinjtë dhe te njerëzit në përgjithësi, sidomos në një kohë kur të drejtat e njeriut janë sfidë në shumë vende të botës. Bëri të ditur se mundësi të mirë për bashkëpunim në mes të dy shteteve mund të ketë në fushën e digjitalizimit dhe zhvillimin e sektorit të ICT-së në Kosovë. Ajo shprehu besimin se Kosova ka një potencial të madh për të ndërtuar një industri konkurruese të shërbimeve teknologjike, që operojnë në tregjet ndërkombëtare. Lidhur me këtë theksoi se ky zhvillim jo vetëm që ndihmon të rinjtë të punojnë dhe të jetojnë në Kosovë, por gjithashtu u mundëson atyre të paguhen në nivele konkurruese me ato të profesionistëve të BE-së. Në këtë drejtim, tha se Ambasada mund të luajë një rol si një urë lidhëse për të forcuar marrëdhëniet midis diasporës kosovare dhe të rinjve brenda vendit, duke nxitur kështu partneritete që mund të shndërrohen në biznese të suksesshme. Më tej, ajo shprehu kënaqësinë për linjën e re ajrore të drejtpërdrejtë mes Prishtinës dhe Amsterdemit, e cila është një lehtësi për qytetarët e Kosovës, sidomos tani pas liberalizimit të vizave.

Karin Boven, sa i përket linjës së re të fluturimeve të drejtpërdrejta mes Kosovës dhe Amsterdimit, theksoi se kjo linjë është një hap i rëndësishëm për intensifikimin e lidhjeve mes dy vendeve. Ambasadorja theksoi se ndonëse diaspora kosovare në Holandë është vogël me rreth 50,000 njerëz, është një komunitet i mirë arsimuar dhe i integruar, që mund të shërbejë si një urë lidhëse mes Kosovës dhe Holandës. Ajo përmendi se disa kompani holandeze në fushën e IT-së tashmë janë aktive në Kosovë dhe po kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të vendit. Fokusi kryesor i saj, tha se është forcimi i marrëdhënieve mes dy vendeve përmes nxitjes së sektorit privat dhe krijimit të vendeve të reja të punës. Bëri të ditur se javën e kaluar u mbajt një konferencë e në Prishtinë, me pjesëmarrjen e 12 kompanive holandeze dhe rreth 300 mysafirëve. Ajo shprehu dëshirën që të organizohen më shumë ngjarje të ngjashme për të fuqizuar praninë e Holandës në Kosovë dhe për të përdorur ekspertizën holandeze në fushën e menaxhimit të ujërave, duke e konsideruar këtë një fushë strategjike për bashkëpunimin e ardhshëm.

Ariana Musliu-Shoshi, i uroi mirëseardhje ambasadores dhe e uroi atë për detyrën e saj të re. Pyeti ambasadoren se çfarë sheh ajo si sfida kryesore gjatë mandatit të saj në Kosovë, apo nëse ka identifikuar se cilat mund të jenë arritjet e saj në katër vitet e ardhshme.

Karin Boven, duke iu referuar pyetjes së deputetes Musliu-Shoshi, theksoi është e rëndësishme përfshirja e popullatës lokale në proceset e zhvillimit të vendit. Ajo theksoi se pavarësisht kohëzgjatjes së mandatit të saj, është thelbësore të mos harrohen njerëzit e Kosovës në çdo hap të procesit, veçanërisht në çështje që lidhen me dialogun, heqjen e masave, dhe anëtarësimin në organizata ndërkombëtare. Duke theksuar rolin e Holandës si një kontribuuese e madhe për buxhetin e Kombeve të Bashkuara, ambasadorja tha se agjencitë si UNICEF, UN-Women dhe UNDP janë tashmë të angazhuara në projekte të rëndësishme në Kosovë. Synimi i saj, tha se është për të bashkuar forcat me këto organizata dhe për të intensifikuar përpjekjet për përmirësimin e jetës së njerëzve të Kosovës.

Ariana Musliu-Shoshi, bëri të ditur se si anëtare e Komisionit për te Drejtat e Njeriut ka vizituar një spital ku janë duke u trajtuar fëmijët të sëmurë me kancer. Gjatë kësaj vizite iu është thënë se organizata nga vende të ndryshme janë duke e ndihmuar spitalin për sigurimin e terapive kundër kancerit dhe se Holanda është njëri ndër vendet që kontribuon më së shumti në këtë drejtim. Për këtë tha se është shumë falënderuese.

Karin Boven, theksoi se fondacioni Care for Kosovo Kids, e viziton rregullisht Kosovën, dhe është një fondacion cili është aktiv për më shumë se 20 vjet këtu. Bëri të ditur se së bashku me fondacionin ka vizituar spitalet ku është takuar edhe me ministrin e shëndetësisë dhe se është e rëndësishme të shihet se edhe ministria është duke e mbështetur fondacionin kur do që ka iniciativa.

Gazmend Gjyshinca, i uroi mirëseardhje ambasadores në Komisionin për Punë të Jashtme dhe Diasporë. Theksoi se do t'i ngrit dy çështje që janë më shumë burim i një vlerësimi të një perspektive të përgjithshme për marrëdhëniet mes Kosovës dhe Mbretërisë së Holandës. E para tha, se lidhet me nevojën që Holanda të mbështesë Kosovën për të arritur statusin e kandidatit për anëtarësim në Bashkimin Evropian, duke theksuar se kjo është një rrugë e domosdoshme për Kosovën, që të mund të vlerësohet në mënyrë të drejtë, e të qartë për progresin e saj. Duke iu referuar parimit holandez “straight and fair” sugjeron që kjo qasje të zbatohet gjithashtu për Kosovën, duke u vlerësuar për përparimin e saj individual dhe jo vetëm në kuadër të mbështetjes deklarative. Gjyshinca tha, se aktualisht Kosova qëndron në procesin e zgjerimit, por jo si një pjesëmarrëse e plotë, gjë që e bën këtë situatë të duket kontradiktore dhe paradoksale në kontekstin e qëndrimit të Holandës për Ballkanin Perëndimor. Çështja e dytë, tha se ka të bëjë me domosdoshmërinë e fillimit të bashkëpunimit konkret dhe afatgjatë mes Kosovës dhe Holandës. Ai sugjeron që ky bashkëpunim të kalojë përtej kufijve të mandatit të vetëm të një ambasadori dhe të përfshijë fusha të ndryshme me projekte të qëndrueshme që zgjasin përtej një viti. Sipas tij,

marrëdhëniet pozitive do të mbeten vetëm në nivel formal, nëse nuk shoqërohen me bashkëpunime konkrete dhe afatgjata që krijojnë bazë të fortë për zhvillim ndërmjet dy vendeve.

Karin Boven, tha, se sa i përket anëtarësimit të Kosovës në BE, qeveria e saj e ndjek parimin “straight and fair”, duke shtuar se edhe pse në Holandë do të ketë zgjedhje dhe ndoshta ndryshime në qeveri, ky parim do të mbetet konstant. Ambasadorja shtoi se për anëtarësimin e Kosovës në BE është e domosdoshme angazhimi aktiv i ambasadës së saj, duke ndihmuar në ndërtimin e momentumit për Kosovën që të përparojë në këtë rrugë. Ajo gjithashtu përmendi angazhimin në bashkëpunim me organizatat tjera, për të mbështetur projektet që ndikojnë pozitivisht në jetën e fëmijëve dhe komuniteteve në Kosovë. E kupton pozicionin paradoksal të Kosovës në procesin e anëtarësimit dhe se ajo, së bashku me kolegët e saj në Ballkan, po shikon mundësitë për një përfshirje më të madhe dhe për ta çuar këtë qëllim përpara.

Time Kadriaj, e falënderoi ambasadoren për pranimin e ftesës dhe i uroi sukses në misionin e saj. Ajo theksoi se Kosova është një vend me orientim të proevropian dhe se nuk ekziston një alternativë tjetër për vendin. Kosova deklaron në çdo takim se synimi i saj i vetëm është integrimi në BE, mirëpo, vërehet shpesh se përballet me trajtime të dyfishta. Përpjekjet e Kosovës për t’u afruar me Evropën nuk shpërblehen, por përkundrazi shpesh kushtëzohen me rrethana politike dhe se kjo është zhgënjyese për deputetët dhe për popullin e Kosovës. Ajo u shpreh e lumtur që në takimet e fundit është përmendur që Ballkani Perëndimor është pjesë e Evropës, dhe shpreson që ky deklaram të mos mbetet thjesht simbolik, por të pasohet nga veprime konkrete nga vendet e BE-së për ta sjellë çdo vend të rajonit më afër BE-së. Ajo shtoi se, sa më shpejt që Ballkani Perëndimor integrohet në Evropë, aq më shumë do të zbehen dyshimet dhe tensionet në rajon. Theksoi se nëse rajoni arrin anëtarësimin në BE dhe NATO, diskursi politik do të zhvendoset drejt prosperitetit ekonomik, përmirësimit të shëndetësisë, arsimit dhe të gjitha fushave të tjera të jetës. Në përfundim, kërkoi përkrahjen e Holandës në proceset që Kosova po kalon, duke përfshirë anëtarësimin në organizata ndërkombëtare dhe në BE, si dhe në ambiciet e saj për anëtarësim në NATO.

Karin Boven, theksoi se ka vërejtur progresin e bërë nga Kosova dhe se për këtë ka raportuar në Hagë, por shtoi se vendimi për çështje të rëndësishme si anëtarësimi në BE dhe NATO nuk është vetëm në duart e Holandës, pasi që kërkon një konsensus më të gjerë midis vendeve anëtare. Boven pyeti nëse ka pasur ndonjë bashkëpunim ndërmjet dy parlamenteve më parë, sepse Holanda ka programe që janë aktive në rajon, që mund të zgjojnë kureshtjen e deputetëve. Ajo shtoi se bashkëpunimin ndërmjet parlamenteve është një aktivitet që mund të bëhet më shpesh.

Arbreshë Kryeziu-Hyseni, e falënderoi ambasadoren për bashkëbisedimin dhe i uroi punë të mbarë në detyrën e saj të re. Ajo e njoftoi se Kuvendi është drejt fundit të legjislaturës, por shtoi se pas zgjedhjeve do të ekzistojë vullneti i njëjtë për bashkëpunim dhe në fuqizimin e mëtejshëm të bashkëpunimi mes të dy vendeve. Duke iu referuar pyetjes së ambasadores, bëri të ditur se së fundi nuk ka pasur bashkëpunim në nivelin parlamentar dhe se do të ishte shumë mirë nëse një gjë e tillë do të ndodhte në të ardhmen. Kuvendi, tha se e ka themeluar Grupin e tij të miqësisë me Parlamentin e Holandës dhe se ky do të mund të ishte hapi i parë, nëpërmjet të cilit mund të shënohet nisma e këtij bashkëpunimi.

Mbledhja përfundoi në orën 9:45.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.

Arbëreshë Kryeziu-Hyseni,

Kryetare e Komisionit